



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TRANSPORTIT  
DHE INFRASTRUKTURËS  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 1 , Datë 18.04.2014

Për

Për miratimin e projekt-idesë për “ Digën e H/C-it Fangu mbi lumin Fan”.

Në zbatim të pikës dh, neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, si dhe neneve 8, 13, të “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 14.04.2014, mori në shqyrtim plotësimin e dokumentacionit për projekt-idenë nga firma projektuese “AYEN AS ENERGJI SHA” sipas kërkesës në shkresën nr.8 prot. datë 24.03.2014, të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha pasi diskutoi Projekt-idenë në tërësi së bashku me plotësimet nga ana e firmës projektuese “AYEN AS ENERGJI SHA” :

Vendosi:

Të miratojë projekt-idenë për digën e Fangut, me treguesit e mëposhtëm:

Emërtimi i Digës	Lartësia e digës	Niveli normal i rezervuarit	Tipi i digës
Diga e Fangut	87 m	165 m (mnd)	Digë me material vëndi(me gurë) dhe element kundrafiltrimi ekran beton-arme.

Për digën e Fangut, në fazën e projekt-zbatimit duhet të plotësohen kërkesat e Vendimit nr.3 datë 23.11.2012 nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha si dhe të plotësohet e të argumentohet e gjithë problematika e sizmikës si me poshtë :

- Mbetemi me të gjitha kërkesat e argumentimit, sqarimit dhe kompletimit të studimit të digës nga pikëpamja e rezistencës së mjaftueshme sizmike të saj, sipas komunikimeve tona të deritanishme.

Në veçanti, ritheksojmë aspektin e sqarimit të funksionit hyrës (“input”) veprues, sipas një akselerograme të argumentuar dhe amplitudës maximale të saj (PGA, ag) referuar një tërmeti të mundshëm, me periudë përsëritje (“Return Period”) të argumentuar që i përgjigjet rëndësisë dhe madhësisë së digës, gjithashtu dhe të analizës përkatëse në fushën kohore (“Time history analysis”).

Në raportin e fundit të paraqitur nga kompania projektuese “AYEN AS ENERGJI” krahas mungesave që konstatohen lidhur me aspektet e mësipërme vërehet gjithashtu që në fund: Analiza e rezultateve (“Analysis Results”) nuk është analizë krahasimore e detajuar midis zhvendosjeve, sforcimeve dhe deformacioneve që rezultojnë nga veprimi sizmik i konsideruar, me kufijtë e lejuar (normativë) të këtyre madhësive për digën në shqyrtim, prej ku nuk mund të dilet me konkluzione përkatëse mbi sigurinë sizmike të digës.

- Studimi hidrologjik të plotësohet me të dhënat e viteve të fundit Hidrologjike

Me respekt,

**Peri Dishnica**

**Kryetar**